

VENDIM
Nr. 68, datë 8.10.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 8.10.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (Sh) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: SHOQËRIA “A&A International” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori Andon Hila dhe avokati Vangjel Kosta me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Dega e Doganës Kapshticë, përfaqësuar nga kryetari, Dritan Cekani.

Shoqëria “Huawei Technologies Albania” sh.p.k., në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 1176, datë 20.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 2216, datë 11.7.2019, të Gjykatës Administrative të Apelit; 00-2023-4359, datë 2.11.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, shoqërisë “A&A International” sh.p.k., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, Degës së Doganës Kapshticë, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, shoqërisë “Huawei Technologies Albania” sh.p.k., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “A&A International” sh.p.k. (*kërkuësja*) është person juridik që ushtron veprimtarinë në fushën e transporteve dhe speditonit. Nëpërmjet deklaratave doganore të datës 25.2.2008 ajo ka kryer procedura doganore pranë Degës së Doganës Kapshticë, duke kaluar mallra nëpërmjet kësaj pike. Duke pretenduar se shuma e paguar është më e lartë se detyrimi i saj, në datën 4.2.2012 kërkuësja i është drejtuar me kërkesë Degës së Doganës Kapshticë për rishikimin e deklaratave

doganore dhe rimbursimin e shumës 5,409,296 lekë, kërkesë që është rrëzuar nga subjekti i interesuar.

2. Kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt rimbursimin e deklaratave tatimore të datës 25.2.2008, të derdhura tepër pranë Degës së Doganës Kapshticë, çështje që është regjistruar në gjykatë në datën 16.2.2012. Gjatë gjykimit, në seancën gjyqësore të datës 15.4.2013, bazuar në nenin 193 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), gjykata ka vendosur të thërrasë, në cilësinë e personit të tretë, subjektin e interesuar, shoqërinë “Huawei Technologies Albania” sh.p.k., duke çmuar se kishte interes në gjykim, pasi mallrat e zhdoganuara ishin dërguar për llogari të kësaj shoqërie, ndërkohë që paditësja (kërkuesja) ka cilësinë e agentit doganor, duke vepruar si përfaqësues i asaj shoqërie. Në vijim, në seancën gjyqësore të datës 20.5.2013, gjykata ka konstatuar se asnjë nga përfaqësuesit e paditëses (kërkueses) nuk është paraqitur në gjykim edhe pse ajo ka pasur dijeni rregullisht sipas fletëthirrjes së datës 30.4.2013 dhe se nuk është paraqitur ndonjë shkak i ligjshëm për mosparaqitjen e tyre. Gjikata e Rrethit Gjyqësor Korçë (*Gjykata e Korçës*), duke vlerësuar se ishin të pranishme kushtet e nenit 179, paragrafi i parë, të KPC-së, pasi ndodhej përpara rastit të mosparaqitjes së paditëses për shkaqe të paarsyeshme, me vendimin nr. 1176, datë 20.5.2013, ka vendosur pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje civile. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 502, datë 6.11.2013, të Gjykatës së Apelit Korçë, ndërkohë që Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 3379/482, datë 28.9.2016 ka prishur vendimin e gjykatës së apelit për shkak se ishin shkelur dispozitat ligjore për kompetencën lëndore dhe çështja është dërguar për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

3. Me vendimin nr. 2216, datë 11.7.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se vendimi i ankimuar është reflektim i dispozitave ligjore procedurale që kanë shërbyer si referencë ligjore (neni 179, paragrafi i parë, i KPC-së). Sipas gjykatës së apelit, në harkun kohor një vjeçar të gjykimit të konfliktit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesat e vazhdueshme të palës paditëse për shtyrje të seancave gjyqësore, pavarësisht se pengesat nuk përlligjin mosparaqitjen e secilit përfaqësues. Lidhur me seancën e fundit gjyqësore, datë 20.5.2013, gjykata e apelit ka vlerësuar se përfaqësuesit e palës paditëse, me gjithë marrjen dijeni rregullisht, nuk janë paraqitur në gjykim, duke mos bërë paraprakisht me dije shkaqet e mosparaqitjes. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2023-4359, datë 2.11.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas atij kolegji në rekurs nuk ngrihen problematika që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material ose procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore apo se vendimi bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë. Sipas tij, shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë mjaftueshëm përgjigje nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, duke i bërë një analizë të hollësishme dispozitave të KPC-së që rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim, kurse pretendimet që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

5. Në datën 15.2.2024 kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000 është regjistruar në datën 5.3.2024.

6. Me vendimin e datës 18.4.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

7.1. E drejta për proces të rregullt në drejtim të:

7.1.1. *Së drejtës së aksesit*, pasi gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë mënyrën e zbatimit të ligjit procedural, sjelljen e palëve dhe vetë jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, që ka bërë dallimin mes zbatimit të legjislacionit material dhe atij procedural. Ky i fundit është ai i momentit në të cilin zgjidhet mosmarrëveshja dhe ai zbatohet menjëherë, përveçse kur vetë ligji parashikon ndryshe. Referuar nenit 34, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, mosparaqitja e palëve në seancë nuk shkakton shtyrjen ose pushimin e gjykimit, pra mungesa e palëve në një gjykim administrativ nuk sjell pushimin e tij. Për rrjedhojë, gjykatat duhet të kishin vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Korçës dhe dërgimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë për vijimin e gjykimit. Kjo lloj mënyre interpretimi është e vetmja e mundur, duke shkruar kështu gjykatat në favor të aksesit të kërkuarës.

7.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në datën 13.7.2023 përfaqësuesi i kërkuarës ka paraqitur në Gjykatën e Lartë një “notë verbale” ku parashtrohej se edhe pse zbatimi i ligjit nr. 49/2012 është bërë në një kohë të mëvonshme gjykata civile nuk mund të mos respektonte dispozitat procedurale që i përkasin këtij lloj gjykimi. Gjykata e Lartë nuk ka mbajtur qëndrim nëse mund ta shqyrtonte këtë “notë verbale” dhe as për vetë pretendimin e parashtruar në të. Po kështu, në pjesën arsyetuese Gjykata e Lartë ka referuar si bazë të interpretueshme ligjin nr. 49/2012 përpara datës 5.5.2017, referencë që është e gabuar duke qenë se rekursi është i datës 19.10.2020.

7.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka mbajtur në konsideratë faktin se kërkuarja kishte shumë për të humbur për shkak të institutit të parashkrimit, sidomos duke pasur parasysh se vetëm pak muaj më pas hyri në fuqi ligji nr. 49/2012 që parashikonte se mosprania e paditësit nuk passjell pushimin e gjykimit në shkallë të parë. Ky parim është cenuar edhe për shkak të referencës nga Gjykata e Lartë në një ligj që nuk ishte i aplikueshëm në atë kohë, çka ul besueshmërinë e kërkuarës dhe publikut të drejtësisë e dhënë. Po kështu nuk janë mbajtur në konsideratë vendimet e kolegjeve të Gjykatës së Lartë në lidhje me pushimin e gjykimit në raste të mungesës së paditësit. Në raste të ngjashme ajo gjykatë ka theksuar se mungesa e paditësit nuk duhet të interpretohet *apriori* si mungesë vullneti, por duhet të hetohet dhe vërtetohet me aktet përkatëse të administruara në gjykim shkaku i mosparaqitjes, i cili përkon me vullnetin për vazhdimin e procesit gjyqësor.

7.2. *E drejta e pronës private* pasi rimbursimi i deklaratave tatimore përbën një pasuri të cilën kërkuarja do të duhej ta kishte marrë, ndërkohë që moskryerja e këtij rimbursimi për shkak të mosgjykimit të themelit të çështjes e cenon këtë të drejtë.

8. *Subjekti i interesuar, Dega e Doganës Kapshticë*, ka prapësuar si vijon:

8.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit* është i pabazuar, pasi pushimi i gjykimit është një nga pasojat e mosparaqitjes së palëve në gjykim pa shkak të arsyeshëm. Mbrojtja e interesave të kërkuarës është bërë nga tre përfaqësues, sipas autorizimeve përkatëse, ndaj në datën dhe orën e gjykimit mund të ishte paraqitur çdonjëri prej tyre. Në harkun kohor një-vjeçar të gjykimit Gjykata e Korçës ka pranuar kërkesa të vazhdueshme të paditëses për shtyrje të seancave, çka provon se ajo nuk ka treguar interesin e duhur gjatë atij gjykimi. Edhe pse seanca gjyqësore ishte planifikuar në orën 13:00, gjykata ka pritur deri në orën 13:15 dhe me mosparaqitjen e paditëses ka vendosur pushimin e gjykimit në bazë të nenit 179, paragrafi i parë, të KPC-së. Është vetë kërkuarja që nuk ka respektuar dispozitat procedurale, ndërkohë që ajo është bërë shkak edhe për zvarritje të gjykimit. Gjykatat kanë vlerësuar të gjitha rrethanat, faktin se kërkuarja kishte dijeni dhe nuk është paraqitur, se kishte kërkuar mjaft herë shtyrjen e gjykimit, se është pritur tej orës së caktuar për zhvillimin e seancës, ndaj nuk mund të pretendohet për shkelje procedurale.

8.2. *Pretendimi për cenimin e standardit të arsytimit* është i pabazuar pasi gjykata e shkallës së parë në vendim ka pasqyruar qartë hetimin që ka bërë ajo, verifikimin e shkakut, analizën e qëndrimit në përgjithësi të palës paditëse gjatë gjykimit, pritjen e saj pas orës së caktuar të seancës, si dhe referencën ligjore të zbatueshme. Edhe vendimet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë përmbajnë shkaqet e ankimit, dispozitat e zbatueshme, si dhe qëndrimin e atyre gjykatave.

8.3. *Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar pasi në momentin e gjykimit të çështjes në shkallë të parë nuk kishte filluar aplikimi i ligjit nr. 42/2012. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 53 të vitit 2012 dhe në zbatim të nenit 70, pika 5, të tij, me dekret të Presidentit është caktuar data 4.11.2013 për fillimin e funksionimit të gjykatave administrative. Ligji nr. 49/2012 nuk ka pësuar ndryshime të tilla që do të sillnin cenim të interesit të kërkuësës, pra cenim të këtij parimi. Nëse do të pranohej e kundërta do të cenohej interesi juridik i palës së paditur në gjykim nga mosaplikimi i njëjtë dhe i barabartë i nenit 2 të KPC-së. Kërkuësja është kontradiktore në pretendimet e saj, pasi në një moment shprehet se duhet të zbatohet ligji nr. 49/2012 duke mos u pushuar çështja, dhe, nga ana tjetër, pranon se ligji ka hyrë në fuqi më vonë se data e gjykimit, pra pranon se dispozitat e tij nuk mund të zbatoheshin, pasi nuk ishin bërë të aplikueshme në momentin e gjykimit.

8.4. I pabazuar është edhe *pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës private*, pasi nuk ka ardhur asnjë cenim i kësaj të drejte nga pala e paditur në gjykim dhe as nga gjykatat.

9. Subjekti i interesuar, shoqëria “Huawei Technologies Albania” sh.p.k., nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

11. Kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

12. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se objekt i kërkesës në shqyrtim është kundërshtimi i vendimit gjyqësor që ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes së kërkuësës, i cili është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta. Ky vendim, edhe pse për nga natyra e tij nuk ka zgjidhur në mënyrë përfundimtare themelin e çështjes së kërkuësës, duke pasur parasysh se me të është dhënë fund procesit gjyqësor të vënë në lëvizje prej saj, duke mos marrë ajo kështu përgjigje për kërkimet dhe pretendimet e ngritura në kërkesëpadi, si dhe duke pasur parasysh se ky është edhe thelbi i pretendimeve të ngritura në ankimin kushtetues individual, Gjykata vlerëson se ky vendim konsiderohet përfundimtar për gjykimin kushtetues dhe se kërkuësja nuk ka mjete të tjera në dispozicion për mbrojtjen e interesave të saj të ligjshme dhe të të drejtave të pretenduara të cenuara.

13. Për sa u përket pretendimeve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës rezulton se pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës private nuk

është ngritur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë por është parashtruar për herë të parë përpara kësaj Gjykate, për rrjedhojë ai nuk mund të merret në shqyrtim pasi konsiderohet se kërkesja nuk ka shteruar mjetet e ankimit në lidhje me të. Në lidhje me pretendimet e tjera të parashtruara nga kërkesja, që kanë të bëjnë me procesin e zhvilluar në gjykatat e faktit, ato rezultojnë të jenë parashtruar në thelb në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kurse për pretendimet në lidhje me procesin e zhvilluar në atë gjykatë kërkesja nuk ka mjet tjetër në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, konsiderohet se në lidhje me to kërkesja i ka shteruar edhe në substancë mjetet juridike të ankimit.

14. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi më i fundit i kundërshtuar nga kërkesja, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 2.11.2023, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 15.2.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

15. Për sa i përket legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit për shkak të pushimit të gjykimit nga Gjykata e Korçës, të standardit të arsytimit të vendimit dhe të parimit të sigurisë juridike për shkak të mënyrës së zbatimit të dispozitave të KPC-së që parashikojnë rastet dhe shkaqet për të cilat gjykata vendos pushimin e çështjes. Sipas kërkeses, Kolegji Administrativ nuk ka pasur në konsideratë as vetë qasjen që ka mbajtur Gjykata e Lartë në çështje të ngjashme, e cila ka theksuar se mungesa e paditësit nuk duhet të interpretohet *apriori* si mungesë vullneti, por duhet të hetohet dhe vërtetohet shkaku i mosparaqitjes. Gjykata, bazuar në natyrën e këtyre pretendimeve dhe shkaqet mbi të cilat kërkesja i ka mbështetur, vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, pretendim që bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohet në vijim në drejtim të bazueshmërisë së tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

16. Sipas kërkeses, gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë mënyrën e zbatimit të ligjit procedural, sjelljen e palëve dhe vetë jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, që ka bërë dallimin mes zbatimit të legjislacionit material dhe atij procedural, që është ai i momentit në të cilin zgjidhet mosmarrëveshja dhe zbatohet menjëherë, përveçse kur vetë ligji parashikon ndryshe. Sipas saj, referuar nenit 34, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, mosparaqitja e palëve në seancë, pra mungesa e palëve në një gjykim administrativ nuk pasqyell pushimin e tij. Kërkesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ nuk ka pasur në konsideratë as vetë qasjen që ka mbajtur Gjykata e Lartë në çështje të ngjashme, ku është vlerësuar se mungesa e paditësit në seancë nuk duhet të interpretohet *apriori* si mungesë vullneti për shkak të mosveprimit për të vënë në lëvizje gjykatën, por duhet të hetohet dhe vërtetohet me aktet përkatëse të administruara në gjykim shkaku i mosparaqitjes. Po sipas saj, edhe pse në Gjykatën e Lartë është paraqitur një “notë verbale” për zbatimin e ligjit nr. 49/2012, ajo nuk ka mbajtur qëndrim të shprehur në lidhje me këtë pretendim.

17. Sipas subjektit të interesuar, Degës së Doganës Kapshticë, mbrojtja e interesave të kërkeses është bërë nga tre përfaqësues, sipas autorizimeve përkatëse, ndaj në datën dhe orën e gjykimit mund të ishte paraqitur çdonjëri prej tyre. Për më tepër, në harkun kohor një-vjeçar të gjykimit Gjykata e Korçës ka pranuar kërkesa të vazhdueshme të paditëses për shtyrje të seancave, çka provon se ajo nuk ka treguar interesin e duhur gjatë atij gjykimi ndërkohë që ajo gjykatë, edhe pse seanca gjyqësore ishte planifikuar në orën 13:00, ka pritur deri në orën 13:15 dhe me mosparaqitjen e paditëses ka zbatuar nenin 179, paragrafi i parë, të KPC-së. Sipas këtij subjekti, gjykatat kanë pasqyruar në vendim hetimin që kanë kryer, verifikimin e shkakut, analizën e qëndrimit të paditëses gjatë gjykimit, shkaqet e ankimit, dispozitat e zbatueshme, si dhe qëndrimin e tyre. Në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 49/2012, ky subjekt ka prapësuar se në momentin e gjykimit të çështjes në shkallë të parë nuk kishte filluar aplikimi i këtij ligji dhe kërkesja edhe pse shprehet se duhet të zbatohet ligji nr. 49/2012 duke mos u pushuar çështja, nga ana tjetër pranon se ai ka hyrë në fuqi më vonë se data e gjykimit, pra pranon se dispozitat e tij nuk ishin bërë të aplikueshme në momentin e gjykimit.

18. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, Gjykata ka vlerësuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 63, datë 23.9.2015; nr. 55, datë 18.12.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, në kuadër të parimit të subsidiaritetit, ajo ka detyrimin t'u përgjigjet të gjitha pretendimeve me natyrë kushtetuese dhe në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 29, datë 1.11.2022; nr. 19, datë 7.7.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për interesat që ai përfaqëson (*shih vendimin nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Duke pasur parasysh standardet e mësipërme, në referim të përmbajtjes së pretendimeve të parashtruara nga kërkuesja, Gjykata do të ndalet në vijim në vlerësimin nëse gjykatat e zakonshme, përmes qëndrimit të tyre në rastin e kërkueses, duke vendosur pushimin e çështjes për shkak të mosparaqitjes së saj në seancë gjyqësore, i kanë cenuar të drejtën për të pasur përgjigje përfundimtare për themelin e mosmarrëveshjes për të cilën ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor dhe nëse qëndrimi i gjykatave më të larta gjatë shqyrtimit të ankimit/rekursit për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykata e shkallës së parë plotëson kriteret e arsytimit në aspektin kushtetues.

21. Gjykata, referuar akteve të çështjes konkrete në shqyrtim, vëren se kërkuesja, shoqëria "A&A International" sh.p.k., pasi i është drejtuar fillimisht organit administrativ për rimbursimin e deklaratave doganore të datës 25.2.2008, të derdhura pranë subjektit të interesuar, Degës së Doganës Kapshticë, ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor me të njëjtin objekt, çështje që është regjistruar në Gjykatën e Korçës në datën 16.2.2012. Referuar të dhënave që rezultojnë nga përmbajtja e akteve të dosjes gjyqësore, rezulton në seancën e datës 10.4.2012 është deklaruar i hapur shqyrtimi gjyqësor dhe gjykata ka pranuar kërkesën e palës së paditur për t'i lënë kohën e nevojshme për të sjellë praktikën doganore. Seanca e datës 26.4.2012 nuk është zhvilluar për shkak të mungesës së gjyqtarit, kurse seancat e datave 16.5.2012 dhe 5.6.2012 janë shtyrë për t'i lënë kohë paditëses për të paraqitur disa prova dhe për të paguar vlerën 3% të shumës së kërkuar. Seanca e datës 26.6.2012 është shtyrë me kërkesë të paditëses, kurse seanca e datës 11.7.2012 është shtyrë për shkak se paditësja nuk rezultonte të kishte marrë dijeni. Kjo çështje është rishortuar në datën 5.9.2012 dhe është caktuar një gjyqtare tjetër për gjykimin e saj. Seanca gjyqësore e datës 26.9.2012 është shtyrë për shkak të mosmarrjes dijeni të kërkueses, në situatën që njoftimi ishte bërë në

adresën e selisë së saj, të paraqitur në kërkesëpadi, për të cilën paditësja kishte njoftuar më parë gjykatën se ishte ndryshuar, ndaj gjykata ka vendosur njoftimin në adresën e selisë së re. Në seancën e radhës të datës 16.10.2012 gjykata ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndërkohë që seanca e datës 7.11.2012 është shtyrë mbi bazën e kërkesës së paditësjes. Në seancën e datës 21.11.2012 nuk është paraqitur asnjë nga palët dhe ka rezultuar se paditësja nuk ka marrë dijeni për seancën, pasi gabimisht njoftimi për të është bërë në adresën e mëparshme. Në seancën e datës 11.12.2012 palët kanë dhënë shpjegime dhe kanë paraqitur pretendimet e tyre, kurse seanca e datës 10.1.2013 është shtyrë për t'i lënë kohë përfaqësueses së re të palës së paditur që të njihej me provat. Në seancën e datës 5.2.2013 palët kanë dhënë shpjegime e kanë parashtruar kundërshtimet e tyre dhe gjykata u ka lënë kohë (mbi kërkesën e tyre) që të paraqisnin provat e kërkuara, si dhe për rregullimin e objektit të padisë nga paditësja (kërkuesja).

22. Seancat e datave 28.2.2013 dhe 25.3.2013 janë shtyrë mbi bazën e kërkesës së paditësjes për pamundësi të paraqitjes së përfaqësueses së saj në gjykim. Në seancën e datës 15.4.2013, gjykata, pasi ka dëgjuar palët dhe është shprehur për pranueshmërinë e provave, ka vendosur, bazuar në nenin 193 të KPC-së, thirrjen në gjykim, në cilësinë e personit të tretë, të shoqërisë “Huawei Technologies Albania” sh.p.k., pasi ka çmuar se ka interes në gjykimin e çështjes. Në seancën e radhës, datë 30.4.2013, nuk është paraqitur asnjë nga palët dhe as personi i tretë. Gjykata ka vendosur gjykimin në mungesë të palës së paditur, pasi nuk është paraqitur pa pasur shkak të ligjshëm, përsëritjen e njoftimit për personin e tretë, pasi njoftimi për të rezulton të jetë i pavlefshëm, në kuptim të nenit 122 të KPC-së, pasi fletëthirrja përmbante nënshkrimin e një personi që nuk deshifrohej se kujt i përkiste, kurse për paditësen, e cila kishte paraqitur kërkesë për shtyrje, njoftimin për seancën e radhës datë 20.5.2013, ora 13:00. Në seancën e kësaj date, e cila sipas procesverbalit të seancës rezulton të ketë filluar në orën 13:15, gjykata ka konstatuar se nuk është paraqitur përfaqësuesi i paditësjes, edhe pse kishte dijeni rregullisht për gjykimin nga fletëthirrja e datës 30.4.2013, e nënshkruar nga i njëjti person që kishte nënshkruar të gjitha fletëthirret e ndodhura në dosjen gjyqësore drejtuar asaj pale dhe se nuk ishte paraqitur ndonjë shkak i ligjshëm për mosparaqitjen. Gjykata ka konstatuar se përfaqësuesi i palës së paditur, për të cilën gjykimi zhvillohej në mungesë, kishte paraqitur kërkesë për shtyrjen e asaj seance, ndërkohë që përfaqësuesi i personit të tretë nuk ishte paraqitur, edhe pse kishte marrë dijeni rregullisht nga fletëthirrja e datës 30.4.2013 dhe nuk kishte paraqitur ndonjë shkak të ligjshëm për mosparaqitje. Për rrjedhojë, Gjykata e Korçës, duke vlerësuar se ndodhej në kushtet e zbatimit të nenit 179, paragrafi i parë, të KPC-së, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes.

23. Gjykata Administrative e Apelit (e përcaktuar nga Gjykata e Lartë si gjykata kompetente për shqyrtimin e ankimit të kërkueses), ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Korçës është reflektim i dispozitave ligjore procedurale që kanë shërbyer si referencë ligjore e tij. Gjykata e apelit ka konstatuar se mbrojtja e interesave të paditësjes është realizuar nga tre përfaqësues dhe se në harkun kohor një-vjeçar të gjykimit gjykata e shkallës së parë ka pranuar kërkesat e vazhdueshme të asaj pale për shtyrje të seancave gjyqësore (të datave 7.11.2012, 28.2.2013, 25.3.2013 dhe 30.4.2013), pavarësisht se pengesat nuk përlligjinin mosparaqitjen e secilit përfaqësues. Lidhur me seancën gjyqësore të datës 20.5.2013, gjykata e apelit, ka konstatuar se përfaqësuesit e palës paditëse, me gjithë marrjen dijeni rregullisht, nuk janë paraqitur në gjykim, duke mos bërë paraprakisht me dije shkaqet e mosparaqitjes. Sipas asaj gjykate, në ankim paditësja ka parashtruar si shkak se ka marrë dijeni paraprakisht për mosparaqitjen në seancën gjyqësore të përfaqësueses së palës tjetër, si dhe se përfaqësuesi i saj ishte paraqitur me vonesë dhe nuk ishte thirrur nga gjykata. Për rrjedhojë, gjykata e apelit ka vlerësuar se kërkuesja ka konfirmuar mosparaqitjen e përfaqësuesve të saj në seancë, për shkak të vlerësimit që ata i kanë bërë kryesisht ecurisë së saj, duke hamendësuar shtyrjen për mosparaqitje të përfaqësueses së palës së paditur. Për sa i takon pretendimit për mbërritjen me vonesë të përfaqësuesit të kërkueses gjykata e apelit ka konstatuar se seanca gjyqësore edhe pse ishte planifikuar për t'u çelur në orën 13:00 është çelur në fakt në orën 13:15, pikërisht në pritje të përfaqësuesve të palës paditëse. Gjykata e apelit, bazuar në nenin 3 të KPC-së, referuar detyrimeve të palëve sipas nenit 175 të këtij kodi, ka vlerësuar se paditësja nuk ka përmbushur detyrimin për

t'u paraqitur në datën dhe orën e caktuar, ose në rast pamundësie objektive, për të paraqitur shkaqe dhe prova që ligjëronin mosparaqitjen, ndaj vendimi i gjykatës së shkallës së parë është diktuar nga rrethanat e parashikuara në nenin 179, paragrafi i parë, të KPC-së (*shih faqet 11–13 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

24. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i vënë në lëvizje mbi rekursin e kërkuar, ka vendosur mospranimin e tij, pasi ka vlerësuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe se në të nuk ngrihen problematika që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural nga gjykatat më të ulëta dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore apo se vendimi bie ndesh me praktikën e konsoliduar të Kolegjit Administrativ, apo vendimet e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë mjaftueshëm përgjigje nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, duke i bërë një analizë të hollësishme dispozitave të KPC-së që rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim dhe, nga ana tjetër, pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih faqet 6–7 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

25. Gjykata vlerëson të theksojë, së pari, se ligji procedural zbatohet menjëherë në përputhje me parimin *tempus regit processum* dhe në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe (*shih vendimet nr. 1, datë 26.1.2021; nr. 3, datë 11.2.2021; nr. 11, datë 23.4.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata vëren se kërkesëpadia është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë në datën 16.2.2012 dhe vendimi i asaj gjykate është dhënë në datën 20.5.2013, për rrjedhojë gjykimi është zhvilluar mbi bazën e dispozitave procedurale në fuqi në kohën e shqyrtimit të çështjes.

26. Gjykata vëren se sipas nenit 179, paragrafi i parë, të KPC-së, në kohën e gjykimit të çështjes: “nëse paditësi ose asnjë nga palët, pa ndonjë shkak të arsyeshëm, nuk paraqiten, si në veprimet përgatitore ashtu edhe në seancën gjyqësore dhe rezulton se kanë dijeni rregullisht, gjykata apo gjyqtari i vetëm vendos pushimin e gjykimit”, kurse sipas nenit 299 të këtij kodi, gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: “a) asnjëra prej palëve nuk kërkon brenda gjashtë muajve rifillimin e gjykimit të pezulluar me kërkesën e tyre, kur gjykata nuk ka caktuar në vendimin e pezullimit një seancë të ardhshme; b) paditësi beq dorë nga gjykimi i padisë; c) pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj.”. Referuar përmbajtjes së këtyre dispozitave procedurale, mosparaqitja e palës paditëse pa shkaqe të arsyeshme përbënte shkak për pushimin e gjykimit. Megjithatë, duke pasur parasysh se përmbajtja e këtyre dispozitave është e lidhur, në thelb, me mungesën e interesit të palës paditëse për zhvillimin e gjykimit, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e së drejtës së aksesit në gjykim, si e drejta që i jep mundësinë palës të mbrojë përpara gjykatës të drejtat e interesat e saj të ligjshëm, si dhe të ushtrojë në gjykim edhe të drejtat e tjera që i garantohen në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, për gjykimin kushtetues merr rëndësi mënyra se si gjykatat kanë interpretuar dhe zbatuar këto dispozita procedurale në çështjen konkrete. Po kështu, duke pasur parasysh parashikimet e ligjit nr. 49/2012 në drejtim të pasojave që passjell për gjykimin mosparaqitja e palëve në seancë gjyqësore, duke mos e klasifikuar shprehimisht mosparaqitjen e paditësit në seancë gjyqësore si shkak për pushimin e gjykimit, sikundër edhe ndryshimet që kanë pësuar dispozitat e KPC-së, të cilat kanë plotësuar dhe nxjerrë në pah rolin dhe rëndësinë e secilës prej fazave të gjykimit, edhe pse ato nuk kanë qenë të zbatueshme në kohën e gjykimit të çështjes në shkallë të parë, Gjykata vlerëson që të verifikojë nëse ajo gjykate, ashtu si edhe gjykatat më të larta gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruara nga kërkuarja në ankim dhe rekurs, kanë analizuar dhe zbatuar dispozitat procedurale të zbatueshme në rastin konkret nën frymën ligjit, referuar për këtë edhe këtyre dispozitave të reja.

27. Gjykata çmon të theksojë në këtë drejtim se ndërsa zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, detyrë e kësaj Gjykate është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr.*

33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 9, datë 27.2.2024; nr. 30, datë 29.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata vëren se gjykatat e faktit, pasi kanë verifikuar faktin se paditësja kishte marrë dijeni për seancën gjyqësore, kanë vlerësuar se edhe pse kishte tre përfaqësues të zgjedhur asnjëri nuk është paraqitur në seancën gjyqësore dhe as nuk është paraqitur ndonjë shkak i përligjur për mosparaqitjen në gjykim. Po kështu, gjykatat kanë konstatuar edhe se kërkesja kishte paraqitur më parë disa kërkesa të tjera për shtyrjen e seancave gjyqësore, të cilat ishin pranuar, duke u shtyrë gjykimi. Nga ana tjetër, kërkesja ka pretenduar se administratori i saj është nisur për në Korçë për të marrë pjesë në seancën gjyqësore të datës 20.5.2023, por ka arritur me vonesë dhe pavarësisht se ka pritur në mjediset e gjykatës, nuk është thirrur për zhvillimin e seancës. Po kështu, sipas kërkeses, paraprakisht përfaqësuesi i saj ishte njoftuar nga juristja e Degës së Doganës Kapshticë (pala e paditur) se kishte depozituar kërkesë për shtyrje të seancës për shkak të pamundësisë për të marrë pjesë në të, çka rezulton e pasqyruar edhe në procesverbalin e asaj seance gjyqësore. Kërkesja ka pretenduar se duke qenë se nuk i është komunikuar njoftimi për seancën pasardhëse është paraqitur në gjykatë për të pyetur, moment në të cilin është vënë në dijeni për vendimin e gjykatës për pushimin e gjykimit.

29. Referuar përmbajtjes së procesverbaleve të seancave gjyqësore të zhvilluara në Gjykatën e Korçës (*shih paragrafët 21 dhe 22 më lart*), rezulton se ajo gjykatë, duke vlerësuar se thirrja në gjykim e subjektit të interesuar, shoqërisë “Huawei Technologies” Albania sh.p.k., ishte me interes për gjykimin e çështjes, ka shtyrë seancën me qëllim njoftimin e saj në cilësinë e personit të tretë. Seanca e radhës është shtyrë për shkak se ka rezultuar se personi i tretë nuk ishte njoftuar rregullisht, si dhe se paditësja kishte paraqitur kërkesë për shtyrje. Në seancën pasardhëse, datë 20.5.2013, gjykata ka konstatuar mungesën e përfaqësuesve të kërkeses dhe të personit të tretë, të cilët edhe pse kishin dijeni rregullisht nuk kishin paraqitur shkaqe të arsyeshme për mosparaqitjen, si dhe mungesën e përfaqësuesit të palës së paditur që kishte paraqitur kërkesë për shtyrje të seancës. Në prani të këtyre rrethanave, Gjykata e Korçës ka vendosur të pushojë gjykimin, në zbatim të nenit 179, pika 1, të KPC-së, bazuar vetëm mbi konstatimin e mungesës së paditëses (kërkeses) pa shkaqe të arsyeshme, por pa bërë asnjë vlerësim në lidhje me shkakun për të cilin ishte vendosur shtyrja e seancave të fundit gjyqësore, që ishte thirrja dhe dëgjimi i personit të tretë, për të cilin ajo gjykatë kishte vlerësuar se kishte interes për gjykimin. Gjykata vëren se ndërsa kërkesja (pala paditëse) dhe pala e paditur në gjykim kishin bërë pjesë të shqyrtimit gjyqësor pretendimet e tyre, duke u dëgjuar nga gjykata në lidhje me kërkimet e kërkesëpadisë dhe prapësimet për to, pra duke iu garantuar e drejta për të paraqitur provat e tyre e për t’ia nënshtruar ato debatit gjyqësor, duke përmbushur kështu edhe qëllimin e të provuarit të interesit për atë gjykim, qëllimi i shtyrjes së seancave gjyqësore ishte që gjykata të dëgjonte personin e tretë, pasi kishte vlerësuar se kishte interes për çështjen. Ndodhur në këtë fazë të gjykimit, Gjykata e Korçës duhej të shtynte formalisht gjykimin, për sa kohë që jo vetëm që kërkesja nuk rezulton të ketë qenë shkakun për shtyrjen e seancave të fundit gjyqësore, por duke pasur parasysh jo vetëm se personi i tretë i thirrur, shoqëria “Huawei Technologies Albania” sh.p.k., nuk ishte i pranishëm, ndaj nuk mund të paraqiste qëndrimin dhe mendimin e tij për vijimin e gjykimit, por edhe se pala e paditur kishte paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës gjyqësore.

30. Gjykata, duke iu referuar dispozitave me natyrë procedurale që rregullojnë procesin administrativ, siç është edhe çështja në shqyrtim, ashtu edhe dispozitave të KPC-së të ndryshuara, vëren se në drejtim të pasojave të mosparaqitjes së palëve në seancë, neni 34, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, i cili ka filluar të zbatohet pas fillimit të funksionimit të gjykatave administrative, parashikon se kjo nuk shkakton shtyrjen apo pushimin e gjykimit. Për sa u përket ndryshimeve të

KPC-së, të vitit 2017, ato nxjerrin në pah rolin e veprimeve përgatitore, duke përcaktuar rëndësinë e seancës gjyqësore në drejtim të formalizimit të pretendimeve të palëve dhe marrjes së provave të identifikuar dhe të kërkuara nga ato gjatë veprimeve përgatitore. Duke rrjedhur në këtë mënyrë gjykimi civil, ndërsa gjithçka rreth tij është projektuar gjatë veprimeve përgatitore, mosparaqitja e paditësit në seancë gjyqësore pa ndonjë shkak të arsyeshëm është konsideruar si rast për pushimin e gjykimit të çështjes. Për rrjedhojë, edhe pse kjo dispozitë procedurale ka ruajtur, në thelb, të njëjtin rregullim në drejtim të pasojave të mosparaqitjes së palëve, ajo që merr rëndësi për Gjykatën është qëllimi i këtij rregullimi, pra arsyet për të cilat mosparaqitja e paditësit në seancë gjyqësore përbën shkak për pushimin e gjykimit. Është e qartë se mosparaqitja e paditësit pengon gjykimin e çështjes për sa kohë pengon gjykatën ta zhvillojë atë në respektim të parimeve të tij të materializuara në nenet 1 e vijues të KPC-së. Nisur nga kjo, mosparaqitja e paditësit në seancë gjyqësore, në thelb, lidhet me mungesën e interesit të tij për vijimin e gjykimit dhe jo thjesht me mosrespektimin prej tij të vendimit të gjykatës për datën dhe orën e zhvillimit të seancës gjyqësore. Duke pasur parasysh se rregullat e procesit civil kanë për qëllim të mundësojnë zhvillimin e tij duke i garantuar paditësit të drejtën e aksesit, për gjykatën që shqyrton çështjen merr rëndësi që të provohet, qoftë edhe përmes interpretimit të sjelljeve të paditësit përgjatë procesit gjyqësor, mungesa e interesit të tij për vijimin e gjykimit. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se thjesht mosparaqitja e paditësit në seancën gjyqësore të radhës pa paraqitur shkaqe të arsyeshme për mungesën e tij, edhe nëse provohet marrja dijeni, ndërkohë që rezulton se deri në atë moment ai ka shfaqur në mënyrë të vazhdueshme interes për gjykimin, duke përmbushur çdo detyrim ligjor që mundëson gjykimin e padisë, nuk mund të interpretohet *apriori* se prezumon mungesën e interesit të tij për gjykimin, me pasojën e pushimit të gjykimit të çështjes sipas nenit 179 të KPC-së.

31. Gjykata ka theksuar se gjykatat duhet të shkojnë përtej tekstit formal të ligjit dhe përmes interpretimit të frymës dhe qëllimit të normës ligjore të synojnë vetë të drejtën. Në kushtet që vendimi i pushimit të gjykimit sjell pasoja në drejtim të aksesit të individit në gjykim, jo vetëm në drejtim të marrjes së një përgjigjeje përfundimtare për kërkimet e ngritura në padi, por, gjithashtu, sepse ndikon edhe në afatin e parashkrimit për ngritjen sërish të padisë, qëllimi i ligjvënësit në miratimin e nenit 179 të KPC-së ka qenë i lidhur me mungesën apo humbjen e interesit të paditësit për vijimin e gjykimit, çka mund të rezultonte edhe nga mosparaqitja e tij në gjykim pa i bërë të ditur gjykatës ndonjë shkak të arsyeshëm. Kjo konfirmohet edhe nga rregullimet procedurale për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative sipas ligjit nr. 49/2012, ashtu dhe përmirësimet ligjore që ka pësuar ligji procedural civil në aspektin e rregullimit përmbajtësor të procesit, të cilat, në thelb, synojnë të garantojnë edhe të drejtën e aksesit në gjykim. Për rrjedhojë, edhe pse arsyetimi i Gjykatës së Korçës, nga pikëpamja formale, duket i rregullt, në thelbin e tij ky arsyetim nuk ka analizuar faktet e mësipërme të konstatuara në gjykimin kushtetues me qëllim të arritjes në përfundimin për mungesën e interesit të paditëses (kërkueses) për vazhdimin e gjykimit, duke mos synuar kështu të drejtën dhe duke sjellë, për pasojë, cenimin e së drejtës së saj të aksesit në drejtim të së drejtës për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet e ngritura në kërkesëpadi.

32. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

33. Duke pasur parasysh natyrën e pretendimeve dhe të shkeljes së konstatuar, Gjykata vlerëson se mënyra më e drejtë për korrigjimin e kësaj shkeljeje është kthimi i çështjes për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, sipas kompetencës së tyre, si gjykata kompetente për të shqyrtuar në themel kërkesëpadinë e kërkueses.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2023-4359, datë 2.11.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, nr. 2216, datë 11.7.201, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe nr. 1176, datë 20.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 8.10.2024.

Shpallur më 6.11.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim